

Programi IPA 2013 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë



Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën

(EuropeAid/135700/DH/SER/AL)

DRAFTI FINAL I VKM

“PËR MBETJET E NGURTA DHE SHKARKIMET NË AJËR DHE NË UJË NGA INSTALIMET QË PRODHOJNË DIOKSID TITANI”

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian





Titulli i Projektit:	Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën
Akronimi i Projektit:	IBECA
Numri i Projektit:	Europe Aid/135700/DH/SER/AL
Data e fillimit të projektit:	22 Qershor 2015
Data e përfundimit të projektit:	21 Dhjetor 2018
Autoriteti Kontraktues:	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri ABA Business Centre Rruga Papa Gjon Pali II, Tirana, Albania. Z. Kai NAGEL, Menaxher Sektori, Mjedisit & Energjia Tel: +355 4 222 8320, Fax: +355 4 223 0752 e-mail: Kai.NAGEL@eeas.europa.eu
Përfituesi:	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Rruga "Norbert Jokl", ish ATSH, Tiranë, Shqipëri. Evisi Kopluku Drejtor, Drejtoria e Integritimit, Koordinimit, Marreveshjeve dhe Asistences Mob: +355694397595 e-mail: Evisi.Kopluku@turizmi.gov.al
Kontraktori:	Agrotec SpA Lungotevere Michelangelo, 9 - 00192 Roma, Italia Kastriot Koshaj Menaxher Projekti Tel: +39 063609381, Fax: +39 0636093861 e-mail: info@agrotec-spa.net
Titulli i Dokumentit:	Drafti Final i VKM "Për mbetjet e ngurta dhe shkarkimet në ajër dhe në ujë nga instalimet që prodhojnë dioksid titani"

Shënim:

Ky raport është përgatitur nga një ekip i projektit që punon për Agrotec. Gjetjet, konkluzionet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë vetëm të Agrotec dhe nuk duhet të konsiderohen në asnjë mënyrë sikur reflektojnë opinionet dhe politikatat e Komisionit Evropian.

Autori i draft VKM:

Prof.Ass.Dr.MSc. Narin PANARITI – Zevendes Drejtuese e Projektit – narin_panariti@yahoo.co.uk

Data e draft VKM: 18 Tetor 2018

Tabela e përmbajtjes

KAPITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	4
Seksioni 1 - Qëllimi.....	4
Seksioni 2 - Objekti.....	5
Seksioni 3 - Përkufizime	5
Seksioni 4 - Kërkesa specifike për instalimet që prodhojnë dioksid titani.....	5
Seksioni 5 - Ndalimi i asgjësimit të mbetjeve	5
Seksioni 6 - Kontrolli i shkarkimeve në ujë	5
Seksioni 7 - Parandalimi dhe kontrolli i shkarkimeve në ajër	5
Seksioni 8 - Vetëmonitorimi i shkarkimeve	6
Seksioni 9 - Dispozita përfundimtare.....	6
Shtojcë: Kërkesa teknike për instalimet që prodhojnë dioksid titani.....	7



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

VENDIM

(Drafti final, date 18.10.2018)

Nr. _____, datë _____

Për

“Për mbetjet e ngurta dhe shkarkimet në ajër dhe në ujë nga instalimet që prodhojnë dioksid titani”¹

Në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 102 të Kushtetutës dhe paragrafit 5 të nenit 25 të Draftit 2 Versioni 1 të Ligjit “Për lejet e mjedisit dhe nenit 39 të Ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe me propozim të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

KAPITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Seksioni 1 - Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë mbrojtje të mjedisit si një i tërë, përmes vendosjes së disa kërkesave mjedisore për instalimet që prodhojnë dioksid titani dhe për përfshirjen e këtyre kërkesave në lejen e tyre të mjedisit.

¹Ky Vendim transponon PJESËRISHT Dokumentin 32010L0075

DIREKTIVA 2010/75/EU E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT, datë 24 nëntor 2010 për shkarkimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes) (Rishkruar) (OJ L 334, 17.12.2010, f. 17–119). Ai transponon PLOTËSISHT Kapitullin VI dhe Aneksin VIII të kësaj Direktive.

Seksioni 2 - Objekti

Neni 66 Objekti

Ky vendim zbatohet për instalimet që prodhojnë dioksid titani.

Seksioni 3 - Përkufizime

Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim si në draft ligjin “Për lejet e mjedisit”.

Seksioni 4 - Kërkesa specifike për instalimet që prodhojnë dioksid titani

1. Pavarësisht nga kërkesat e përcaktuara në draft Ligjin “Për lejet e mjedisit”, leja e mjedisit për instalimet që prodhojnë dioksid titani, përveç kërkesave të përgjithshme të lejes, do të përfshijë edhe kërkesa specifike që lidhen me këtë industri specifike.
2. Në hartimin e lejes së mjedisit për një instalim të përmendur në paragrafin 1, AKM do të marrë parasysh edhe plotësimin e kërkesave të këtij vendimi.

Seksioni 5 - Ndalimi i asgjësimit të mbetjeve

Neni 67 Ndalimi i asgjësimit të mbetjeve

Ndalohet asgjësimi në çfarëdo lloj trupi uJOR apo në det i mbetjeve të mëposhtme:

- a. mbetjet e ngurta;
- b. lëngjet që dalin nga faza e filtrimit pas hidrolizës së tretësirës së sulfatit të titanit në instalimet që kryejnë procesin e sulfatit; përfshirë mbetjet acide në këto ujëra, të cilat përmbajnë më shumë se 0,5 % acid sulfurik të lirë dhe metale të rënda të ndryshme, përfshirë edhe ato ujëra që janë holluar deri sa të përmbajnë 0,5 % apo më pak acid sulfurik të lirë;
- c. mbetjet nga instalimet që kryejnë procese të klorurit, që përmbajnë më shumë se 0,5 % acid klorhidrik të lirë dhe metale të rënda të ndryshme, përfshirë mbetje të tilla që janë holluar deri sa të përmbajnë 0,5 % apo më pak acid klorhidrik të lirë;
- d. kripëra filtrimi, llumrat dhe mbetjet e lëngëta që dalin nga trajtimi (përqendrimi ose neutralizimi) i mbetjeve të përmendura në paragrafët (b) dhe (c) dhe me përmbajtje metalesh të rënda të ndryshme, por që nuk përfshijnë mbetjet e neutralizuara dhe të filtruara apo të dekantuar, që përmbajnë vetëm gjurmë të metaleve të rënda dhe që, para hollimit, kanë pH më të lartë se 5,5.

Seksioni 6 - Kontrolli i shkarkimeve në ujë

Neni 68 Kontrolli i shkarkimeve në ujë

Shkarkimet në ujë nga këto instalime nuk lejohet të tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Pjesën 1 të Shtojcës së këtij vendimi.

Seksioni 7 - Parandalimi dhe kontrolli i shkarkimeve në ajër

Neni 69 Parandalimi dhe kontrolli i shkarkimeve në ajër

1. Shkarkimi i piklave të acidit nga këto instalime do të parandalohet.
2. Shkarkimet në ajër nga këto instalime nuk do të tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Pjesën 2 të Shtojcës së bashkëngjitur këtij Vendimi.

Seksioni 8 - Vetëmonitorimi i shkarkimeve

Neni 70 Monitorimi i shkarkimeve

1. Operatori që administron instalime që prodhojnë dioksid titani do të bëjë monitorimin e shkarkimeve në ujë dhe në ajër.
2. Monitorimi i shkarkimeve në ajër do të përfshijë të paktën monitorimin e shkarkimeve të përcaktuara në Pjesën 3 të Shtojcës së bashkëngjitur këtij Vendimi.
3. Operatori i përmendur në paragrafin 1 do ta raportojnë të dhënat e vetëmonitorimit të tyre në AKM.
4. Inspektorati Shtetëror përgjegjës për Mjedisin do të bëjë inspektime për të verifikuar respektimin e kushteve të lejes për shkarkimet në ujë të përcaktuara nga AKM dhe kërkesat e Pjesës 6 të këtij Vendimi, si dhe kushtet e përcaktuara për shkarkimet në ajër dhe kërkesat e Pjesës 7 të këtij Vendimi.
5. Operatori i përmendur në paragrafin 1 do të bëjë vetëmonitorimin në përputhje me standardet CEN ose, nëse nuk ekzistojnë standarde CEN, në përputhje me standardet ISO, standardet kombëtare ose standarde të tjera ndërkombëtare që sigurojnë ofrimin e të dhënave me të njëjtën cilësi shkencore.

Seksioni 9 - Dispozita përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ministria, AKM dhe Inspektorati Shtetëror përgjegjës për mjedisin.
2. Ky vendim do të botohet në Gazetën Zyrtare dhe do të hyjë në fuqi me miratimin dhe hyrjen në fuqi të draft ligjit "Për lejet e mjedisit".

Shtojcë: Kërkesa teknike për instalimet që prodhojnë dioksid titani

PJESA 1

Vlerat kufi të shkarkimeve në ujë janë si më poshtë:

1. Në rastin e instalimeve që përdorin procesin e sulfatit (si mesatare vjetore): 550 kg sulfat për ton dioksid titani të prodhuar.
2. Në rastin e instalimeve që përdorin procesin e klorurit (si mesatare vjetore):
 - a. 130 kg klorur për ton dioksid titani të prodhuar duke përdorur rutile neutrale,
 - b. 228 kg klorur për ton dioksid titani të prodhuar duke përdorur rutile sintetike,
 - c. 330 kg klorur për ton dioksid titani të prodhuar duke përdorur skorie. Instalimet që derdhin mbetje në ujëra të kripura (estuarinë, bregdetare, në det të hapur) mund t'u nënshtrohen vlerave kufi të shkarkimeve prej 450 kg klorur për ton dioksid titani të prodhuar duke përdorur skorie.
3. Për instalimet që përdorin proceset e klorurit dhe më shumë se një lloj xeherori, vlerat kufi të shkarkimeve në paragrafin 2 zbatohen në raport me sasinë e xeherorit të përdorur.

PJESA 2

Vlerat kufi të shkarkimeve në ajër janë si më poshtë:

1. Vlerat kufi të shkarkimeve të shprehura si përqendrim në masë për metër kub (Nm^3) llogariten në temperaturë 273.15 K dhe në presion 101.3 kPa.
2. Për pluhurin: 50 mg/Nm^3 si mesatare për orë nga burimet më të mëdha dhe 150 mg/Nm^3 si mesatare për orë nga burimet e tjera.
3. Për dioksidin dhe trioksidin e squfurit në gjendje të gaztë të shkarkuar nga tretja dhe kalcinimi, përfshirë pikat e acidit të llogaritur si ekuivalent SO_2 :
 - a. 6 kg për ton dioksid titani të prodhuar si mesatare vjetore;
 - b. 500 mg/Nm^3 si mesatare për orë për impiantet për përqendrimin e mbetjeve acide.
4. Për klorurin në rastin e instalimeve që përdorin procesin e klorurit:
 - a. 5 mg/Nm^3 si mesatare ditore;
 - b. 40 mg/Nm^3 në çdo kohë.

PJESA 3

Monitorimi i shkarkimeve

Monitorimi i shkarkimeve në ajër do të përfshijë të paktën monitorimin e vazhdueshëm të:

- a. shkarkimeve të gazta të dioksidit dhe trioksidit të squfurit nga tretja dhe kalcinimi në impiantet për përqendrimin e mbetjeve acide në procesin e sulfatit;
- b. klorit nga burimet kryesore brenda instalimeve që përdorin proceset e klorurit;
- c. pluhurit nga burimet kryesore.